



Zjarrfiksat e juaja ju informojn...



Çfarë duhet të bëni para se të filloj te digjet:

JU DUHET TË INFORMOHENI,

Se si ju nga Banesa juaj ose nga Dhomat do të mundeni të shkoni deri te Shkallët, koridorin, dalja dhe daljen emergjente!

Ku është telefoni më i afërt, treguesi tjetër i zjarrit ose alarmi i shtëpis!

Se si bëhet një thirrje korrekte në rast emergjent!

Ku gjinden bombolat kundër zjarrit dhe paisjet tjera për fikjen e zjarrit dhe si duhet te përdoren ato!

KINI KUJDES

Që të gjitha rrugët- dhe daljet e shpëtimit gjithmonë të jen të lira! Shkallët janë rrugë të shpëtimit! Ato gjithmon duhet të jenë të kalueshme. Ato nuk jane vende për deponim të gjësendeve.

që dyert ne keto rrugët të shpëtimit duhet mbajtur të mbyllura për të parandaluar përhapjen e zjarrit dhe tymit!

që rrugët ansore te ndërtesat dhe hidranti nuk janë dëmtuara ose janë jashtë funksionimit.

që paisjet e sigurisë dhe paisjet për luftimin e zjarrit nuk janë të dëmtuara apo të mos jenë jashtë funksionit.

KUJDES ME PËRDORIMIN E ZJARRIT DHE ENERGJINË ELEKTRIKE!

Duhanpirësit duhet gjithmon të përdorni take të materialit jo-djegshmëm; kurrë nuk duhet të vendoset në shportën e mbeturinave! Të respektohen vendet ku ndalon pirjen e duhanit!

Zjarri hapur dhe burime të tjera të ngrohjes nuk duhet të lënë pa mbikëqyrje! Hekuri për hekurosje, vendet e gatimit apo ngrohje elektrike, etj janë poaq të rrezikshme si një zjarr i hapur.

Mos i mbuloni kurrë/asnjeher paisjet elektrike!

Paisjet elektrike të dëmtuara ose jo mir të riparuar, poashtu edhe kabllat e gjata, përmbajn një rrezik të madhë për hapjen e zjarrit elektrik dhe rreziqe elektrike dhe për këtë arsye nuk duhet të përdoren!

Kabllot e thyera ose shpërndarës elektrik të shumtë mund të jenë të mbingarkuar dhe munden të nxehen dhe kështu të shkaktojnë zjarrë!

Çfarë duhet të bëni në rast zjarri:

MBAJENI QETËSIN

dhe shmangien e panikes është e rëndësishme së veçant ! Kush është në panik, ka pak shanca për të mbijetuar një situatë të rrezikshme pa lëndime!

SHKONI NË VENDE TË SIGURTA

poashtu paralajmërojni bashbanuesit!

Kushtoj vëmendje të veçantë njerëzve që kanë nevojë për ndihmë. Fëmijët dhe nevojtarin kanë përparësi, sepse ata janë më pak në gjendje të ndihmojnë veten!

Nëse është e mundur, mbyllni dritaren!

Gjithsesi duhet mbyllur dyert që të mos përhapet/zgjerohet zjarri dhe tymi!

Të largoheni me shpejtësi nga Banesa apo Shtëpia!

Asnjëherë mos përdorni ashensorë sepse mund të ju zihet fryma. Ashensori do të ndalet nëqoftëse do të ndalet energjia elektrike!

Të gjithë banorët e shtëpis të mbliidhen përpara shtëpisë dhe ti presin zjarrfikësit!

Të jeni në dispozicion për pyetjet e zjarrfikësve ose të policisë!

NËQOFTËSE TË GJITHA RRUGËT E SHPËTIMIT JANË MBYLLUR

Shkoni në një dhomë ku nuk tym, mbylleni deren dhe me rroba ose me qarshafa/batanije mbylleni të gjitha vrimat/birat!

Në dritaren e hapur të thirrni për ndihmë!

Asnjëherë mos u hidheni verbërisht nga dritarja!

ZJARRFIKËSIT TI ALARMONI

në numrin e telefonin 112!

Tregojeni emrin tuaj,

çfarë ka ndodhur,

ku ka ndodhur,

sa njerëz janë në rrezik.

Përgjigjuni edhe pyetjeve tjera!

Mbani lidhjen! Biseda ka përfunduar vetem nga Qendra e kordinimit!

ZJARRET E VOGLA MUNDUHUNI VETE TI FIKNI

por në asnjë mënyrë nuk të sjellëni veten në rrezik! Tymi është poashtu i rrezikshë si vetë zjarri –por shumë më i shpejtë!

NJË TJETËR SHËNIM:

Për të gjitha problemet e mbrojtjes nga zjarri do të ndihmojë zjarrfikësit lokal.

Erstellt 2016 von:

H. Erichsen

Beauftragter für Brandschutzerziehung und –aufklärung
der Feuerwehren im Amt Mittelangeln, Schleswig-Holstein

Ein besonderer Dank an:

Herrn Shpejtim Kastrati,

Übersetzungsbüro Kastrati, Bad Oldesloe,
für die Korrektur der Albanisch-Übersetzung